REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1092/20
Datë/Datum. 18.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues	*Data e autorizimit të ekspertit:* **15.12.2020**	*Data e dorëzimit të raportit:* **18.12.2020**	*Nr. i lëndës:* **1092/20**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **14.12.2020**, grupi i OE: **"Triangle" Sh.p.k. & "Globi-Mi" Sh.p.k.- Suharekë,** ka parashtruar ankesë me nr.: **1092/20**, kundër **B58 - njoftimit mbi vendimin e AK, (vendimi për anulimi e aktivitetit te prokurimit)**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Projekt me bashfinancim -Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqeve në fshatrat e Komunës së Suharekës**", me nr. të prokurimit: **624-20-2918-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Komuna Suharekë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedura e hapur**, lloji i kontratës: **Punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **274,174.10 €**

Shënim: Ju njoftojë se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë nxjerr dy (2) vendim nga OSHP-ja
PSH nr. 592, 619/20, datë: 28.09.2020
PSH nr. 847/20, datë: 16.11.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: "Triangle" Sh.p.k. & "Globi-Mi" Sh.p.k.- Suharekë

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 9 i LPP-së
Neni 22 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 8 i RRUOPP-së
Neni 44.5 i RRUOPP-së.
Vendimi i OSHP-së nr.592,613/20.
Vendimi i OSHP-së nr. 847/20.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Te nderuar ne me dt. 02.12.202 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se, ku e keni anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se "*Një shkelje e LPP ka ndodhur apo do te ndodhin ne procedurën e prokurimit e cila nuk mund te rregullohet apo te parandalohet përmes një amendamenti ligjore te kushteve te prokurimit*".

Fillimisht ju sqarojmë se ju me dt. 27.11.2020 keni nxjerr njoftim mbi vendimin e AK-se ku na keni rekomanduar për kontratë.

Ju sqarojmë se arsyetimi i juaj për anulimin e aktivitetit te prokurimit është i pa bazuar për arsyet si ne vijim:
Fillimisht përderisa ju si AK e keni filluar procedurën pa u bazuar ne mjetet nga MAPL tani është absurd fakti ku ju arsyetoheni për humbje te garantit.
Ky arsyetim i juaj është absurd për faktin se ju si AK nuk jeni bazuar askund se nëse Granti nuk do te ekzistonte, atëherë kontrata nuk do te lidhet.
Ky fakt dokumentohet edhe tek dosja e tenderit ku ne pjesën tek kushtet e pagesës nuk është e specifikuar se këto mjete do te paguhen nga granti MAPL. Andaj duke u bazuar ne këtë fakt lëshimet eventuale nga ndonjë institucion nuk duhet te merren si përfundimtare sepse eventualisht këto lëshime na dëmtojnë neve si OE ne këtë aktivitet te prokurimit.
Ju si AK-se ne fillim me dt. 13.08.2020 e keni nënshkruar edhe deklaratën e nevojave dhe disponushmërisë se mjeteve konform nenit 9 te LPP-se, ndërsa ne këtë dispozite shkruan: "*Para se te fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti te prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet te siguroje qe te behet një vlerësim formal i nevojave dhe qe rezultatet e këtij vlerësimi te regjistrohen formalisht me shkrim dhe te ruhen ne dokumentacionin e autoriteti kontraktues*".

Gjithashtu edhe neni 22 i LPP-se paragrafi 2 e parasheh qarte si ne vijim: "*Pasi ZKA t'i ketë dorëzuar Zyrtarit Autorizues Deklaratën e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të përgatitur në mënyrë të rregullt dhe të nënshkruar nga ZKA dhe ZKF, Zyrtari Autorizues e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioje aktivitetin e prokurimit. Zyrtari Autorizues e autorizon inicimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për inicimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruar. Zyrtari i Prokurimit do të mban një kopje të këtyre dokumenteve në dokumentacionin për prokurimin përkatës. Zyrtari Autorizues gjithashtu i dërgon një kopje të udhëzimit të tij me shkrim ZKF-së dhe ZKA-së të autoritetit kontraktues si dhe funksionarit më të lartë të autoritetit kontraktues, përveç kur ZKA është funksionari më i lartë*".

Edhe neni 8 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ per Prokurim Publik (RRUOPP) tek " Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponushmërisë se fondeve" shkruan qarte si ne vijim:
"*AK do të inicioi një aktivitet të prokurimit vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave, pse saktësisht nevojitet prokurimi. Qëllimi i vlerësimit paraprak të nevojave bëhet që të sigurohet që bëhen vetëm prokurime të sakta dhe të nevojshme, dhe të evitohet prokurimi jo-efikas si dhe te sigurohet qe lendet qe i përmbushin këto nevoja nuk janë ne dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik*".
Pra ju si autoritet kontraktues keni qene te obliguar me ligj, qe nga fillimi ti ndjekin hapat dhe proceset e prokurimit, e jo te veproni ne mënyrë subjektive dhe diskriminuese duke e anuluar aktivitetin ne fjale.

Ju si AK na keni dëmtuar neve si OE fillimisht ne humbje te kohës ne përgatitjen e tenderit ne vazhdimësi dhe ne shpenzime te konsiderueshme ne ankesa dhe tani kur përgatitem te gjitha kapacitetet për fillim te punëve, behet anulimi nga ana juaj, e qe është dem për neve si OE dhe natyrisht ne dem te qytetareve.

Andaj duke u bazuar ne faktet e lartcekura shihet qarte se vendimi i juaj për anulimin e aktiviteti te prokurimit është i pa bazuar dhe gjithashtu duke u bazuar ne këto fakte duhet te behet vazhdimi i këtij aktiviteti te prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës me kompaninë tone, pasi qe jemi ofertues i përgjegjshëm me çmimin me te lire edhe pse MAPL ka tërhequr grantin. Ju si AK duhet te siguroni mjete qe projekti te vazhdoj, pasi qe ky projekt është i rëndësishëm për qytetaret dhe qytetin e Suharekës. Me këtë veprim tuajin neve po na krijohet përshtypja se ju si AK, me qellim nuk dëshironi te gjeni zgjidhje apo ndoshta nuk keni vullnet te bëni një gjë te tille.

S.B

Është për tu habitur fakti se si është tërhequr granit ne momentin e rekomandimit tone për kontrate edhe pas te gjitha ankesave te cilat i kemi bere ku e kemi dëshmuar se jemi OE i përgjegjshëm edhe ju si AK na keni shpallur OE te papërgjegjshëm disa here. Pra ju vetëm jeni munduar te vononi këtë aktivitetet te prokurimit, pasi qe e keni stërzgjatur dhe ne fund pasi qe na rekomandoni për kontrate e anuloni aktivitetin e prokurimit.

Andaj duke u bazuar ne te gjitha faktet e lartcekura shihet se ju si AK keni dhen një arsye krejtësisht te pa bazuar ne lidhje me anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit, duke u bazuar ne dispozita ligjore te cilat nuk janë te qëndrueshme.

Përfundimisht ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderove nuk është bere kon formë nenit 59 te LPP-se dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesore për dhënie te kontratës e qe ka qene **tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet**, sipas nenit 60 te LPP-se.

Anulimi i aktivitetit te prokurimit është bere ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara ne këtë dispozite.

Gjithashtu ky anulim i këtij aktiviteti te prokurimit është bere ne kundërshtim me nenin 4.5 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), sepse asnjeri nga kushtet e parashikuara ne këto dispozita nuk janë përmbushur ne këtë rast dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore qe ky aktivitet i prokurimit te anulohet ne këtë faze. Prandaj ne nuk duhet te pësojmë si OE për çështje te cilat nuk varen nga ne, e te cilat çështje dhe procedura mund te zgjidhen nga autoriteti juaj.

Me këtë vendim tuajin si autoritet kontraktues na keni diskriminuar neve ne kundërshtim me nenin 7 te LPP-se, ndërsa ne paragrafin 1 te nenit 7 te LPP-se, parashihet qarte: "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do te veproj ne mënyrë transparente*".

Ju rikujtojmë qe ju si AK duhet te keni ne konsiderate edhe nenin 1 te LPP-se, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimi te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosovë.

Ne fund kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues qe te nxjerrin:

V E N D I M

APROVOHET, ankesa e OE**"TRIANGLE" SH.P.K**
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM, DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK) – Ankesa në OSHP, janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në AK. Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet në - Ankesën në OSHP – janë të njëjta deklaratën me atë te dorëzuar ne kërkesa për rishqyrtim pran AK-se.

S.B

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

OE ankues është shpallur fitues duke rekomanduar për dhënie te kontratës ne platformën elektronike e-prokurim, përmes B57- njoftimi mbi vendimin e AK me date 27.11.2020, mirëpo me date 02.12.2020 përmes B57- njoftimi mbi vendimin, Anulimin e aktivitet te prokurimit , sipas vendimit te Qeverise nr. 01/46 te datës 25.11.2020

AK - ka shkelur nenin 9, 22 dhe 62 te LPP-së, si dhe nenin 8 dhe 44.5 te RRUOPP-së.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:(Tëpërshkruhetvetëmvlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni Pasi beri Rivlersimin e ofertave konkuruese dhe ne baze te velersimit te OSHP-se me nr.847/20 rekomandon ZP-se qe te shpalle fitues OE TRIANGLE SH.P.K &GLOBI M.I SH.P.K me qmim ne vlere prej 263,997.70 euro

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

S.B

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Triangle" Sh.p.k. & "Globi-Mi" Sh.p.k.- Suharekë

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK-së ka shkelur nenin 1, 7, 59, dhe 60 të LLP-së

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, përgjigjeve te pranuar nga AK - ZPP lidhur me sqarimet e kërkuar nga ESH përmes e-mail te datës 16.12.2020, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK me date 13.04.2020 ka nënshkruar marrëveshje për këtë projekt me MAPL-ne lidhur me përfitimin nga skema e grantit për përfitime komunale, kurse publikimin e njoftimit për kontrate dhe dosjen e tenderit ka publikuar ne platformën elektronike e-prokurim me date 16.06.2020, kurse procesverbali i hapes është bere me date 08.07.2020, janë nxjerr dy vendime nga PSH lidhur me këtë aktivitet te prokurimit duke kthyer ne rivlerësim pasi qe AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore te LPP, ku OE ankues ka qene palë e ankese ne vazhdimësi, prandaj bazuar në **Rregulloren e Punës Nr. 01/2020 te datës 03.03.2020 Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit e ndryshuar plotësuar me datën 08.10.2020**, bazuar ne **neni 16 (Rastet e unifikuara)** par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore te njëjta për palët ne procedurë lidhur me këto pretendime ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, për rastet te cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara **"res judikata"**, sipas nenit **105.2.16 te LPP-së**, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka shkelur nenin 9, 22, dhe 62 te LPP-së, si dhe nenin 8 dhe 44.5 te RRUOPP-së

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne B58 - njoftimi mbi vendimin e AK (anulimin e këtij aktivitet te prokurimit), vendimit mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 10.12.2020 nga zyrtari përgjegjës i prokurimit, po ashtu duke marr për bazë **Vendimin e Qeverise nr. 01/46 te datës 25.11.2020, e-mail-in dërguar nga zyrtaret e MAPL**, ku thotë: *"Bazuar në vendimin e qeverisë nr. 01/46 të datës 25.11.2020 për kursime buxhetore, ju njoftojmë se projekti i financuar në komunën e juaj sipas marrëveshjes së mirëkuptimit të datës 24.04.2020 "Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqe në fshatrat e komunës" në vlerë prej 231,956.22€, është pjesë e këtij vendimi për kursime buxhetore, pra këto mjete nuk janë më pjesë e buxhetit të Ministrisë së Pushtetit Lokal"*, duke i marr për bazë gjithë dokumentet, si dhe bazuar ne **nenin 26 par. 4.2 te LPP-së**, po citoj: *"personat kanë konfirmuar edhe një herë se informatat që gjinden në "Deklaratën e Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve" janë ende të sakta;"*, andaj bazuar ne te gjithë e këto dokumente mjetet financiar te parapara për këtë projekt, tani nuk janë pjese e buxhetit te MAPL, prandaj ky aktivitet i prokurimit, **është anuluar ne pajtim** me **paragrafët e nenit 62 të LPP-së**, ku thuhet: *1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: K.1. një shkelje të ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit"*, si dhe AK - ZPP ***ka vepruar ne pajtim*** me **nenin 44.5 të RrUOPP-së**, po citoj: **"-** *Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave, duhet të anulohet për një nga arsyet e më poshtme: (ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;"*. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk **është i qëndrueshëm.**

S.B

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, **të aprovohet si pjesërisht e bazuar**, dhe rekomandon të mbetet ne fuqi vendimi B58 - njoftimit mbi vendimin AK (anulimi i aktivitetit te prokurimit).

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues –Komuna Suharekë*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *Grupi i OE ankues – "Triangle" Sh.p.k. & "Globi-Mi" Sh.p.k.- Suharekë*

S.B